



REPUBLIKA E SHQIPERISË



UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
REKTORATI
DREJTORIA EKONOMIKE

Nr. 1590 Prot.

Tiranë, më 29/06 /2022

Lënda: Mbi miratimin e tarifës së regjistrimit në konkursin/testimin e pranimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, për vitin akademik 2022 - 2023

SENATIT AKADEMIK TË UNIVERSITETIT POLITEKNIK TË TIRANËS

I nderuar Z. Kryetar,

Të nderuar anëtarë,

Me Vendimin nr. 25 datë 12.03.2021 “Për miratimin e kriterëve të pranimit në programet e ciklit të parë të studimeve dhe programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve për vitin akademik 2022 – 2023”, Senati Akademik ka miratuar kriteret e pranimit në programet e studimit në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Në pikën C të vendimit të sipërcituar është parashikuar që për pranimet në programet e integruara të studimit në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, përveç kriterit të notës mesatare, kandidatët duhet ti nënshtrohen dhe zhvillimit të një konkursi/testimi në hyrje, të organizuar nga ky fakultet.

Në vijim të miratimit nga Senati Akademik të zhvillimit të testimit për pranimin në Fakultetin e Arkitekturës dhe Urbanistikës, me vendimin nr. 18, datë 24.05.2022, Dekanati i këtij fakulteti ka miratuar tarifën e regjistrimit të kandidatëve për testin e pranimit në programet e studimit për vitin akademik 2022 – 2023, në shumën 3000 (tre mijë) lekë.

Me shkresën nr. 215/1 prot., datë 30.05.2022, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka dërguar në Rektorat vendimin e Dekanatit për miratimin e tarifës së regjistrimit në shumën 3000 lekë, me qëllim mbulimin e shpenzimeve të ndryshme që parashikohet të kryhen për organizimin dhe zhvillimin e testimit të pranimit në programet e studimit që ky fakultet ofron.

Tarifa e propozuar për tu paguar nga kandidatët aplikues në shumën 3000 lekë, është përlllogaritur duke marrë në konsideratë shpenzimet për organizimin e konkursit/testimit të cilat përfshijnë:

- Pagesë për marrjen me qira të sallës së madhe të Pallatit të Koncerteve në vlerën rreth 540.000 (pesëqind e dyzetë mijë) lekë.

- Kancelari në vlerën rreth 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë;
- Pagesë për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ që angazhohet për organizimin e konkursit (rreth 40 persona) në vlerën rreth 750.000 (shtatëqind e pesëdhjetë mijë) lekë.

Kosto totale e shpenzimeve për organizimin e konkursit të pranimit përlllogaritet në vlerën rreth 1.350.000 (një milion e treqindë e pesëdhjetë mijë) lekë.

Nisur nga të dhënat e viteve të mëparshme, numri i studentëve që pritet të konkurrojnë pranë Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës për të fituar në një program studimi është afërsisht 300 – 350. Të ardhurat që pritet të krijohen nga arkëtimi i kësaj tarife përlllogariten rreth 1.050.000 (një milion e pesëdhjetë mijë) lekë.

Sqarojmë se në vitet paraardhëse dhe konkretisht deri në vitin akademik 2013 – 2014, mbështetur në udhëzimin nr. 17, datë 17.07.2012 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës “*Për zhvillimin e konkurseve të pranimit, tarifën e regjistrimit për konkurimin në disa programe studimi të ciklit të parë me kohë të plotë dhe në programet e integruara të ciklit të dytë në institucionet publike të arsimit të lartë 2013 – 2014*”, për regjistrimin në programet e arkitekturës dhe urbanistikës parashikohej zhvillimi i konkursit/testimit dhe tarifa e regjistrimit e cila ishte në masën 8000 (tetëmijë) lekë.

Në vitet akademike në vijim, kriteret e pranimit në institucionet e arsimit të lartë ndryshuan duke u hequr zhvillimi i testimit për pranimin në degët e arkitekturës dhe urbanistikës.

Në vitin akademik 2019- 2020 me vendim të Senatit Akademik u parashikua përsëri zhvillimi i testimit si kriter pranimi në degët e ofruara nga Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës. Gjithashtu nga ana e fakultetit u propozua aplikimi i një tarife prej 3500 lekë për secilin kandidat për të konkurruar në programet e integruara të ciklit të dytë të studimeve në këtë njësi.

Megjithatë, tarifa e propozuar prej 3500 lekësh nuk u miratua nga Bordi i Administrimit për faktin se shpenzimet për testimin ishin parashikuar dhe miratuar në buxhetin e vitit 2019 të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës, si dhe politikave të institucionit për të lehtësuar kandidatët nga shpenzimet për aksesin në institucionet e arsimit të lartë.

Në dy vitet akademik në vazhdim, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka zhvilluar testimin për pranimin në programet e studimit në këtë fakultet pa një tarifë konkurrimi, për të cilat ka paraqitur dhe kërkesën për shpërblimin e personelit të angazhuar në organizimin e tij.

Për vitin akademik 2022 – 2023, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës ka propozuar që studentët të cilët do të nënshtrohet testimit, të paguajnë tarifën e regjistrimit në shumën 3000 lekë.

Në Statutin e UPT-së neni 26 “Tarifat e studimit”, pika 3 përcaktohet se “Tarifa e studimit miratohet me vendim të Bordit të Administrimit, pasi është marrë mendimi paraprak i Senatit Akademik të UPT, për çdo program studimi, mbi bazën e propozimeve të njëjësive kryesore, në përputhje me legjislacionin në fuqi”.

Mbështetur në Statutin e UPT-së, miratimi paraprak i tarifave të regjistrimit, si dhe i tarifave të shkollimit në programet e studimit në UPT, është atribut i Senatit Akademik.

Për sa më sipër, kërkohet shqyrtimi i propozimit të Fakultetit të Arkitekturës dhe Urbanistikës për miratimin e tarifës së regjistrimit në konkursin/testimin e pranimit në programet e studimit të integruar për vitin akademik 2020 – 2023.

Duke qenë se koha në dispozicion për miratimin e tarifës së regjistrimit është e shkurtër, kërkohet shqyrtimi i çështjes brenda një afati sa më të shpejtë, me qëllim njohjen e studentëve me kriteret dhe detyrimet për kryerjen e pagesës për marrjen pjesë në zhvillimin e konkursit të pranimit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

ADMINISTRATORI

Besmir ALI

